



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/96

Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - TrainKos Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Ramush Ahmeti, kryesues;
 - 1.2. Agim Preniqi;
 - 1.3. Fejzi Kiqina;
 - 1.4. Ylber Shabani;
 - 1.5. Mustafa Mustafa;
 - 1.6. Ramiz Rrustaj.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - InfraKos Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Enver Aruqaj, kryesues;
 - 1.2. Lundrim Camaj;
 - 1.3. Enis Berisha;
 - 1.4. Shkëlqim Osmanaj;
 - 1.5. Nagip Skenderi;
 - 1.6. Arben Dodaj.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Kompania për Menaxhimin e Deponive Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Mentor Hoxhaj, kryesues;
 - 1.2. Gazmend Bytyqi;
 - 1.3. Havë Qarri;
 - 1.4. Bashkim Krasniqi;
 - 1.5. Burim Gashi;
 - 1.6. Selatin Retkoceri.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga Shoqata e Malazezëve të Kosovës, datë 29.03.2019, nr. prot. 01/2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 40,000.00 (dyzetëmijë) euro, sipas kërkesës së Shoqatës së Malazezëve të Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Ministrinë e Financave me kod 201, në nën programin Thesari me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere, për Shoqatën e Malazezëve të Kosovës, llogaria bankare nr. 1501110000384677 Raiffeisen Bank.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli për bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile (referuar më tutje si Këshilli).
2. Këshilli është mekanizmi kryesor i përhershëm këshillues i cili do ta koordinoj të gjithë procesin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile.
3. Përgjegjësitë kryesore të Këshillit janë:
 - 3.1. Koordinon procesin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë civile;
 - 3.2. Monitoron zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë civile;
 - 3.3. Ofron opinione, këshilla dhe rekomandime për projekt aktet ligjore, dokumentet strategjike dhe dokumentet e tjera që ndikojnë në punën dhe zhvillimin e OShC-ve;
 - 3.4. Ofron opinione dhe rekomandime për planet dhe raportet vjetore për shpërndarjen e fondeve publike në mbështetje të programeve dhe projekteve të OShC-ve.
4. Mënyra e punës së Këshillit rregullohet përmes Rregullave të punës së Këshillit për të cilat Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është mandatuar t'i zhvillojë dhe të cilat do të miratohen në takimin e parë të Këshillit.
5. Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë, nga të cilët 14 janë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues nga Shoqëria civile.
6. Nga përfaqësuesit e Shoqërisë civile, 14 prej tyre përzgjidhen nga vet organizatat e shoqërisë civile ndërsa 1 emërohet nga Platforma CiviKos.
7. Mandati i anëtarëve të Këshillit është katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

8. Procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes do të realizohen nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila do të monitorojë tërë procesin. Procedura për përzgjedhjen e përfaqësuesve nga shoqëria civile është e hapur, transparente dhe llogaridhënëse duke marrë parasysh nevojën për të siguruar përfshirjen e spektrit të gjerë të interesave që përfaqësohen nga organizatat e shoqërisë civile.
9. Këshilli drejtohet nga:
 - 9.1. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit - kryesues;
 - 9.2. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit - zëvendës kryesues;
 - 9.3. Përfaqësuesi i emëruar nga Platforma CiviKos - bashkë kryesues.
10. Përfaqësuesit e tjerë të Qeverisë emërohen nga institucionet në vijim, të cilat përfaqësohen në nivel të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe drejtorëve përgjegjës:
 - 10.1. Ministria e Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.2. Ministria e Integritimit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.4. Ministria e Financave, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.8. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar;
 - 10.9. Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar;
 - 10.10. Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar;
 - 10.11. Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtori, një anëtar;
 - 10.12. Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Drejtori, një anëtar;
 - 10.13. Zyra Administrative/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar.
11. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit shërben si Sekretariat i Këshillit dhe do të jetë në funksion për të zhvilluar dhe mirëmbajtur të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.
12. Për funksionimin efektiv dhe punën e suksesshme të këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit në aspektin financiar dhe me burime njerëzore.
13. Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit dhe institucionet e tjera janë të obliguara që të zbatojnë këtë vendim.
14. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/96

Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra dhe paragrafit 8. neni 16 i Ligjit Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Istogut për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 137,033.40 € për projektin e ri "Zëvendësimi i gypit të azbestit".
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës dhe transferohen në Komunën e Istogut me kod 633, në programin Zhvillimi Ekonomik me kod 480 në nën programin Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik me kod 48017 në kategorinë e shpenzimeve kapitale në shumë prej 137,033.40 € në projektin e ri "Zëvendësimi i gypit të azbestit".
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Istogut për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/96

Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/78 të datës 09.03.2016, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 11/141 të datës 07.04.2017.

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/78 i datës 09.03.2016, për qëllimin e përdorimit të kompleksit banesor-afarist "Hade dhe Hade 2", kështu që:
 - 1.1. Pika 4 e Vendimit Nr. 02/78 të datës 09.03.2016, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

"Autorizohet Komuna e Obiliqit që të themelojë Komisionin përkatës për për zgjedhjen e përfituesve të drejtës së banimit në hapësirat sipas destinimit të përcaktuar në pikën 2. të vendimit, nënpika 2.1 dhe 2.2 të këtij vendimi".
 - 1.2. Pika 5, 6 dhe 8 e Vendimit Nr. 02/78 të datës 09.03.2016, fshihen nga teksti i Vendimit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet e nxjerra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/78 të datës 09.03.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 11/141 të datës 07.04.2017.
3. Obligohet Komuna e Obiliqit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 pika 6 të Ligjit Nr. 06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 948,555.00 euro në Buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nga Projekti "Bashkëfinancim me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale" me kod 15525 në 7 (shtatë) projekte kapitale në përputhje me 7 (shtatë) marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga MAPL, donatori dhe kryetarët e komunave për projekte kapitale.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/96

Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronës së paluajtshme ish shoqërore parcela nr.1188-0 ZK Hajvali, Komuna Prishtinë e cila preket nga realizimi i projektit "Rregullimi i shtratit të Përrockës në Hajvali" me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ta largojë nga shtija e aseteve në likuidim nr. 45 në njësinë nr.61-Ratar Tokë Bujqësore Hajvali IV gjegjësisht parcelën kadastrale nr.1188-0 ZK Hajvali, Komuna Prishtinë.
3. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (MMPH), Ministria e Financave, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe Komuna e Prishtinës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 10/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 33 dhe 35A të Ligjit Nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit të Komunave për vitin 2018.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe ministrinë e linjës për zbatimin e rekomandimeve nga ky Raport.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi me Nr. 16/76, i datës 21.11.2018, si në vijim:
2. Ndahen mjete financiare në vlerë 500,000 (pesëqind mijë) euro për Kombëtaren e Kosovës në Futboll.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës, dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në nën programin Sportet e Gjera me kod 80100 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere për Kombëtaren e Kosovës në Futboll.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/96

Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr.07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Sekretariati për monitorimin e implementimit të aktiviteteve nga matrica e bashkëngjitur si rezultat i instrumentit të borxhit të ashtuquajtur si "Operacioni për Zhvillimin e Politikave" në dizajnim nga Ministria e Financave me Bankën Botërore.
2. Sekretariati do të përbëhet si në vijim:
 - 2.1. Ministri i Financave - kryesues i Sekretariatit;
 - 2.2. Ministri i Administratës Publike;
 - 2.3. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
 - 2.4. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 2.5. Koordinatorin Nacional për Reformë Shtetërore;
 - 2.6. Drejtori i Zyrës Ligjore, Zyra e Kryeministrit të Kosovës;
 - 2.7. Drejtori i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, Zyra e Kryeministrit të Kosovës;
 - 2.8. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, Ministria e Financave;
 - 2.9. Drejtori i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave;
 - 2.10. Drejtori i Zyrës Ligjore, Ministria e Financave.
3. Obligohet Kryesuesi i Sekretariatit që të ftojë takime në baza të rregullta mujore për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve respektive të përcaktuara në matricën e cila është pjesë e këtij Vendimi. Në takime, sipas nevojës mund të ftohen edhe përfaqësues të Bankës Botërore për të dhënë mbështetje dhe qartësime për procesin e mbështetjes teknike të ofruar nga ajo në kuadër të implementimit të aktiviteteve.
4. Obligohen të gjitha ministrinë e linjës të realizojnë aktivitetet e përcaktuara në matricën respektive.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

MATRICA INDIKATIVE¹ E POLITIKAVE (LISTA E GATE)

Përshtatshmëria e Kornizës Makroekonomike
Shtylla Indikative A. Menaxhimi i Riskut Fiskal
Objektivi Zhvillimor A i Projektit: Të menaxhohen risqet fiskale përmes vendimarrjes së bazuar në dëshmi dhe transparencës fiskale

Veprime të mëparshme	Subjekti Përgjegjës dhe Treguesi i Rezultateve
<p>1 Menaxhimi i përmirësuar i borxhit</p> <p>Huamartësi ka zgjeruar kornizën e vet të menaxhimit të borxhit publik përmes harmonizimit me legjislacionin tjetër, si dhe duke rregulluar qasjen në tregjet financiare ndërkombëtare nëpërmjet miratimit nga Kuvendi të një Ligji të ri të Borxhit deri në dhjetor 2019.</p>	<p>Subjekti Përgjegjës: <i>Ministria e Financave</i></p> <p>Treguesi i Rezultateve A1 - Korniza Ligjore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (fund-2018): Jo • Caku (fund-2020): Huamartja dhe lëshimi i garancive është kryer në përputhje me kornizën e rishikuar ligjore.
<p>2 Qëndrueshmëri e siguruar fiskale</p> <p>Qeveria ka siguruar qëndrueshmëri fiskale nëpërmjet:</p> <p>(i) krijimit të një grupi punues ndërmarrës për të punuar në legjislacionin dytësor nëpërmjet një vendimi të qeverisë për ligjet e reformës së administratës publike.</p> <p>(ii) hartimit të legjislacionit dytësor që rregullon kompensimet në kuadër të rregullit të pagave të sektori publik në pajtim me ligjin për pagat,</p> <p>(iii) miratimit të legjislacionit dytësor për riklasifikimin e vendeve të punës sipas Ligjit Nr. 06/14 për Zyrat e Publikë,</p> <p>(iv) përmes Ligjit për ndarjet buxhetore për buxhetin 2020, qeveria ka kufizuar punësimin e ri në shtetbimin publik për pozitat ekzistuese të miratuara në Ligjin për ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2019,</p> <p>(v) Ligjit për ndarjet buxhetore për buxhetin 2020, duke përcaktuar vlerën e koeficientit të pagës bazë në vlerën e përcaktuar në Ligjin për ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2019.</p>	<p>Subjekti Përgjegjës: <i>Ministria e Administratës Publike, Ministria e Financave, dhe Zyra e Kryeministrit</i></p> <p>Treguesi i Rezultateve A2 - Kompensimi i të punësuarve si përqindje e BPV-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (fund-2018): xxx për qind e BPV-së • Caku (fund-2020): Ekzekutimi i buxheut për vitin 2020 për kompensimin e punonjësve është xxx për qind e BPV-së dhe është brenda rregullit fiskal për rifjen e pagave

¹ Matrica mund të përshtatet dhe akomodohet vetëm në dakordim të Bankes Botërore si rezultat i ndonjë prethane të re.

3	Cilësi e situat e vlerësimeve të ndikimit fiskal	<p>Qeveria ndjek një strategji të koordinuar për mbrojtjen sociale dhe ka ritur cilësinë e vlerësimeve të ndikimit fiskal përmes</p> <p>(i) ndryshimit të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësishë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, duke përfshirë klauzola që caktojnë përgjegjësine e veprime për propozimin e programeve të reja pensionale ose të përfitimeve sociale ose propozimin e ndryshimeve në programet ekzistuese të pensioneve ose përfitimeve sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në koordinim me MF-në. Edhe Ligji për Qeverinë përfshin një klauzolë për të formuar bazën ligjore për këtë dispozitë;</p> <p>(ii) ndryshimit të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës 09/2011 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit të Buxhetit për Iniciativat e reja Qeveritare, duke kërkuar një analizë aktuale për iniciativat pensionale, e cila zbatohet për dokumentet konceptuale, strategjitë, ligjet dhe aktet nënligjore, di dhe marrjen e një opinioni të Ministrisë së Financave;</p> <p>(iii) ndryshimit të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 3/2015 për Vlerësimin e Ndikimit të Buxhetit për Iniciativat e reja Qeveritare që të kërkojnë përditësime periodike [çdo 5 vjet] të analizës aktuale për pensionet; duke përfshirë një mjet analizash aktuale në udhëzimet për hartimin e dokumenteve konceptuale</p> <p>(iv)</p>	<p><i>Subjekti Përgjegjës: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</i></p> <p>Treguesi i Rezultateve A3 - Analiza aktuale për pensionet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (fund-2018): Nuk ka analizë aktuale • Caku (fund-2020): Qeveria përfundoi dhe publikoi analiza aktuale të paktën për programet pensionale (pensionet bazë, ish-kontributore, ansimi, pensionet e parakohshme për FSK-në)
4	Transparencë e situat e shtuar fiskale	<p>Qeveria ka ritur transparencën fiskale të vlerësimeve të ndikimit fiskal dhe ka përfshirë koston e nismave të reja të shpenzimeve sociale përmes</p> <p>(i) ndryshimit të rregullores 09/2011, duke kërkuar publikimin në internet të vlerësimeve të ndikimit fiskal, të dokumenteve konceptuale, strategjive, ligjeve dhe akteve nënligjore dhe vendimeve të qeverisë me opinionin përkatës të Ministrisë së Financave, dhe (b) publikimin online të të gjitha nismave së bashku me vlerësimet e ndikimit fiskal të miratara që nga viti 2015; nga ZKM në platformën [xxx]; dhe</p> <p>(ii) leshimit të një vendim të Qeverisë për të mos miratuar ndonjë iniciativë të re pensionale dhe sociale derisa të përfundohen veprimet e PA2, dhe të miratohet ligji për ndarjet buxhetore për buxhetin 2020 pa iniciativa [të reja] pensionale dhe përfitimesh sociale me kosto fiskale, me përjashtim</p>	<p><i>Subjekti Përgjegjës: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe Ministria e Financave</i></p> <p>Treguesi i Rezultateve A4 - xxx:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (fund-2018): Shpenzimet për mbrojtje sociale janë xxx për qind e BPV-së • Caku (fund-2020): Shpenzimet për mbrojtje sociale janë xxx për qind e BPV-së në

		<p>të skemës së ndihmës sociale të shënjestruar për varfërinë, dhe me vlerësimet e konsoliduara fiskale të buxheut</p>	fund të vitit 2020
5	<p>Përmirësimi i shënjestrimit të skemës së ndihmës sociale</p>	<p>Huamarrësi ka filluar reformën e skemës së ndihmës sociale me qëllim të përmirësimit të shënjestrimit dhe rritjes së mbulimit të të varfërve;</p> <p>(i) duke eliminuar filtrat kategorikë të Kategorive I dhe II (që çojnë në përjashtimin e familjes pasi femija mbush 6 vjeç ose nëse ka më shumë se një anëtar të familjes jo të varur), dhe duke futur një test të ri të varfërisë nëpërmjet [aprovimit] të një dokumenti të konceptit deri në fund të dhjetorit 2019,</p> <p>(ii) duke pilotuar në mekanizëm të ri të shënjestrimit të varfërisë (testi i ri i mjeteve dhe i mjeteve treguese)</p>	<p>Subjekti Përgjegjës: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</p> <p>Treguesi i Rezultateve A5 – Pjesa e amvisërive të varfra të mbuluara nga skema e asistencës sociale:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (2016): 26% • Caku (fund-2021): xxx <p>Treguesi i Rezultateve A6 – Numri i familjeve me femijë > 6:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Niveli bazë (fund-2018): xxx • Caku (fund-2020): xxx
	<p>Objekti i Zhvillimit: Të krijohet një mjedis biznesi që çon drejt rritjes dhe krijimit të barabartë të vendeve të punës</p> <p style="text-align: center;">Shtylla Indikative B. Zhvillimi i Sektorit Privat</p>		
6	<p>Përmirësimi i mjedisit biznesit nëpërmjet koordinimit më të mirë të inspektiveve</p>	<p>Ligji për Inspektimet miratohet nga Parlamenti deri në nëntor 2019.</p>	<p>Subjekti Përgjegjës: Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë</p> <p>Treguesi i Rezultateve B1 - Zyra e Inspektoratit të Përgjithshëm është themeluar me një sistem plotësisht funksional:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (fund-2019): jo

		<ul style="list-style-type: none"> • Caku (fund-2021): po <p>Treguesi i Rezultateve B2 - Sistemi i inspektimit elektronik është themeluar me një sistem plotësisht funksional:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (fund-2019): jo • Caku (fund-2021): po <p>Treguesi i Rezultateve B3 - Të gjitha inspektimet e biznesit kanë filluar kryerjen e inspektimeve të bazuara në risk, dhe është ulur numri mesatar i inspektimeve për biznes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi bazë (fund-2018): 22 • Caku (fund-2021): xxx <p>Subjekti Përgjegjës: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,</p> <p>Treguesi i Rezultateve B4 - xxx:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Niveli bazë (fund-2019): xxx • Caku (fund-2020): xxx
<p>7</p> <p>Përmitësimi i mjedisit biznesit nëpërmjet reduktimit të barës rregullatore për bizneset duke thjeshtuar licencat dhe lejet</p>	<p>Qeveria ka miratuar dokumentin e konceptit mbi reduktimin e barës administrative që i përket Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, krijuar/përditësuar një regjistër të licencave dhe lejeve, caktuar objektiva për të reduktuar licencat dhe lejet për bizneset dhe filluar procesin e thjeshtimit, bashkimit dhe shfuzizimit të licencave dhe lejeve. Këto ndryshime duhet të pasqyrohen në regjistrin e licencave dhe lejeve.</p>	<p>Subjekti Përgjegjës: Ministria e Financave</p> <p>Treguesi i Rezultateve B5 - xxx:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Niveli bazë (fund-2019): xxx • Caku (fund-2020): xxx
<p>8</p> <p>Përmitësimi i mjedisit biznesit nëpërmjet reduktimit të barës rregullatore për</p>	<p>i</p> <p>Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Qeverisë Vendore ndryshohet [eliminimin e Nenit 8] për ta rregulluar më mirë praktikën e futjes së tarifave dhe licencave lokale, dhe miratohet nga qeveria.</p>	<p>Subjekti Përgjegjës: Ministria e Financave</p> <p>Treguesi i Rezultateve B5 - xxx:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Niveli bazë (fund-2019): xxx • Caku (fund-2020): xxx

	bizneset duke thjeshtuar licencat dhe lejet në nivel lokal		
9	Mjedisi i përmirësuar i biznesit përmes krijimit të një mekanizmi të ankesave për investitorët	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka themeluar një Mekanizëm për Ankesa me anë të një vendimi të Qeverisë.	<i>Subjekti Përgjegjës: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Qeveria</i> Treguesi i Rezultateve B6 - xxx: <ul style="list-style-type: none"> Niveli bazë (fund-2019): xxx Caku (fund-2020): xxx
10	Rruga e efikasitetit dhe barazisë në tregun e punës	Miratohet Ligji i Punës, duke përfshirë dispozita për (i) forma më fleksibël të punësimit, (ii) rrigen e fleksibilitetit të punësimit dhe shkarkimit nga puna, (iii) reduktimin e gjatësisë së tepërt të kontratave të përkohshme, (iv) u parapa sjellja anti-diskriminuese në punë, rruga e mbrojtjes sociale të grupeve më të cenueshme në tregun e punës, dhe (v) u reduktua kostoja e drejtpërdrejtë për punëdhënësit për pagimin e përfitimëve të lindjes.	<i>Subjekti Përgjegjës: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</i> Treguesi i Rezultateve B7 - Zvogëlohet pjesa e të punësuarve me kontrata të përkohshme: <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi bazë (T2 2018): 79.5% Caku (T2 2021): nën 70%
11	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë nëpërmjet operacionalizimit të Fondit për Efikasitet të Energjisë	Miratohen rregulloret e nevojshme për funksionalizimin e fondit, si dhe përfundon emërimi i bordit dhe drejtori menaxhues, duke e bërë fondin operacional.	<i>Subjekti Përgjegjës: Ministria e Zhvillimit Ekonomik</i> Treguesi i Rezultateve B8 - xxx: <ul style="list-style-type: none"> Niveli bazë (fund-2019): xxx Caku (fund-2020): xxx

Qeveria synon të vazhdojë të punojë në fusha të tjera që do të mbështesin objektivat e lartpërmendura:

Rritja e transparencës fiskale për përmirësimin e politikës fiskale	
(i)	ligji i buxhetit për ndarjet buxhetore për buxhetin 2020 ka një seksion mbi shpenzimet tatimore
(ii)	[përmes një udhëzimi administrativ/regullorje] nga A TK-ja kërkohet të publikojë raporte tremujore të progresit në lidhje me objektivat e performancës, duke përfshirë raportimin e borxhit tatimor.
(iii)	janë ndërmarrë hapa për të shlyer borxhin tatimor të vonuar për më shumë se 6 vjet në bazë të [udhëzimit administrativ/regullorës xxx]
(iv)	Në prill 2019 KAMSH përfshin një vlerësim të KAMSH-it të mëparshëm dhe racionalizimin e ndryshimeve në lidhje me KAMSH-in e mëparshëm
(v)	përmes një udhëzimi administrativ kërkohet raportim tremujor publik mbi pagesat e vonuara nga organizata buxhetore, dhe janë përcaktuar masat përmes udhëzimit administrativ për adresimin/zvogëlimin e këtyre pagesave të vonuara
Forcimi i mbikëqyrjes së NP-ve	
(i)	ligji për Ndërmarrjet Publike miratohet nga qeveria dhe dorëzohet në Kuvend
(ii)	Qeveria ka publikuar deri në dhjetor 2019 një pasqyrë financiare të konsoliduar dhe të paudituar të NP-ve për vitin 2018
Reduktimi i rreziqeve fiskale përmes përmirësimit të menaxhimit të burimeve ujore	
Qeveria ka aplikuar parimin "ndotësi paguan" për menaxhimin e mbeturinave industriale dhe të shkarkimeve [përmes një veprimi administrativ/regullorje]	
Përmirësimi i mjedisit të biznesit përmes mundësimin të sistemeve të identifikimit elektronik dhe uljes së kostos për shërbimet digjitale	

(i) Qeveria ka miratuar dhe dorëzuar në Kuvend ligjin për eIDAS (Shërbimet Elektronike të Identifikimit dhe Mirëbesimit) (a) për të siguruar që ndërveprimet elektronike mes biznesit, qytetarëve dhe autoriteteve publike, janë më të sigurt dhe më efektive, (b) për të vendosur një kornizë të vetme për Shërbimet Elektronike të Identifikimit dhe Mirëbesimit për të mundësuar ndërveprimin në të gjithë 28 vendet e BE-së, duke siguruar që vendet t'i njohin reciprokisht shërbimet elektronike të identifikimit dhe mirëbesimit të njëri tjetrit përtej kufijve.

(ii) Projektligji për reduktimin e kostove, i përgatitur nga MZHE, miratohet nga qeveria dhe dorëzohet në parlament për të zvogëluar koston e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë. Kosto të reduktuara të ofrimit të shërbimeve digjitale dhe përmirësimi i konkurrencës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës ekzistuese fizike dhe duke mundësuar një sistem më efikas.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/96


Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr.07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Administratës Publike, me nr. prot. 741, datë 15.03.2019, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ekrem Gjokaj, emërohet Kryeshf Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 3 (tre) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë